

dhënave, përfshirja, validimi dhe mjedisi i grumbullimit për domenet e statistikave; Përmirësimi i efektivitetit të ASK-së; Arkitektura e sistemit të TI-së, që bazohet në procese të përbashkëta dhe të dokumentuara.

ASK-ja edhe gjatë periudhës së ardhshme do t'i jepë përparësi cilësisë, në të gjitha proceset e prodhimit statistikor. Një nga proceset më të rëndësishme të prodhimit statistikor është mbledhja e të dhënave. Prandaj, do të përdoren sisteme të avancuara për mbledhjen e të dhënave nga terreni, siç janë metodat CAPI (Intervistë Personale me Ndhimën e Kompjuterit) dhe CAWI (Intervistë Personale përmes Ueb Aplikacionit). Proces tjetër në sigurimin e cilësisë në prodhimin statistikor është shkurtimi i afateve kohore për publikimin e të dhënave statistikore. Aplikimi i modeleve statistikore GSBPM do ta rrisë kost-efektivitetin e proceseve statistikore dhe do ta ngrisë cilësinë e prodhimeve statistikore.

Objektiva për Sistemin e Integruar Statistikor (SIS) të Teknologjisë Informative do të vazhdojë të jetë objektiv edhe përgjatë periudhës së ardhshme pesëvjeçare. Për arritjen e SIS-it do të ndihmojë realizimi i projekteve që dalin nga zbatimi i interoperabiliteti, sidomos nga përdorimi i sistemeve informative administrative dhe të dhënat nga regjistrat elektronikë, që menaxhohen nga insitucionet e tjera të vendit.

Banka Qendrore e Kosovës

Në mënyrë që të realizojë objektivat e veta, BQK prodhon një gamë të gjerë të statistikave që ofrojnë një pasqyrë statistikore të shëndoshë të zhvillimit të Kosovës në aspektin e sektorit financiar dhe të jashtëm, dhe shkallën e lartë të krahasueshmërisë ndërkombëtare. Progres i rëndësishëm është bërë gjatë viteve të fundit në rritjen e mbulueshmërisë, zgjerim të gamës së statistikave, përmirësim të frekuencës dhe afatit të publikimeve, si dhe ë përmirësim të cilësisë së statistikave që prodhon BQK. Megjithatë, ka disa objektiva për të kompletuar më mirë portofolin e statistikave zyrtare në përgjithësi. Publikimi i produkteve të reja statistikore, rritja e mbulimit, shkurtimi i mëtejme i afateve të publikimeve, konvergjenca e plotë me manualët e reja ndërkombëtare, si dhe konvergjenca me legjislacionin statistikor të BE-së -janë qëllimet që duhet të arrihen në pesë vitet e ardhshme. Vlerësimi i pavarur i zhvillimeve ekonomike është një nga aktivitetet më të rëndësishme për të arritur një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe afatgjatë në Republikën e Kosovës. Prandaj, statistikat që janë në domenin e BQK-së do të avancohen edhe më tutje. Fushat me prioritete strategjike të identifikuar nga BQK për pesë vitet e ardhshme janë paraqitur më poshtë, në kuadër të matricës së objektivave sipas fushave statistikore (shih pjesën statistikat financiare dhe të jashtëm).

Ministria e Financave

Ministria e Financave informon publikun për përmirësimet e mundshme në planin e ardhshëm afatmesëm dhe se si është bërë performanca financiare e Qeverisë. Ministria e Financave është duke zgjeruar përdorimin e standardeve ndërkombëtare dhe teknologjive duke e bere në këtë mënyrë më të lehtë dhe në kohë të arritshem informacionin mbi pageset që ndodhin në vend gjatë një dite. Këto të dhëna janë

paraqitur çdo tre muaj në një format që është i mundur të arrihet në faqen e internetit të Ministrisë. Këto informacione përdoren për të prodhuar vlerësime tremujore makroekonomike dhe publikime gjysmë - vjetore mbi situatën ekonomike në vend.

Qëllimet strategjike kryesore

- Shkurtimi i kohës së informacioneve për Qeverinë e Kosovës për situatën makro-ekonomike dhe financiare;
- Ruajtja e stabilitetit makro-ekonomik të vendit përmes hartimit të politikave të qëndrueshme ekonomike;
- Sigurimi i regjistrimit të faturave me kohë dhe në përputhje me kodet COIFOG;
- Zhvillimi i mëtejshëm në analiza ekonomike;
- Sigurimi i funksionalitetit të vazhdueshëm i sistemit elektronik të llogarive dhe procedurat e tij;
- Sigurimi i zbatimit të legjislacionit tatimor dhe doganor në Republikën e Kosovës;
- Mbikëqyrja e institucioneve të administratës publike për zbatimin e rregullave dhe procedurave në fuqi, përkitazi me shpenzimet publike, duke përfshirë prokurimin publik pa paragjykim ndaj kompetencave të Zyres së Auditorit të Përgjithshëm;
- Ofrimi i politikave të qëndrueshme fiskale;
- Hyrje në borxhe publike sipas legjislacionit në fuqi;
- Bashkërendimi dhe koordinimi i aktivitetve me institucionet ndërkombëtare financiare.

4.2.3 Matricat e objektivave strategjike

4.2.3 Matricat e objektivave sipas fushave statistikore

Matricat e objektivave sipas fushave statistikore janë nxjerrë nga formatet e Qeverisë së Kosovës për dokumentet e karakterit strategjik. Objektivat e fushave janë radhitur sipas pritjeve të kornizës kohore. Në pjesën 4.3. janë dhënë edhe direktivat strategjike.

Statistikat Ekonomike

Veprimi	Institucioni përgjegjës	Institucioni Partner	Treguesit vlerësues	Statusi i gjendjes bazë	Periudha kohore	Fondet
Objektivi i fushës së statistikave ekonomike: promovimi i një kuptimi më të mirë të ekonomisë kosovare, duke siguruar të dhëna të sakta, relevante dhe në kohë, të llogarive kombëtare, çmimeve, statistikave të biznesit, investimeve, tregtisë së jashtme, si një objektivi dhe me kosto-efektive në drejtim të kërkesave të BE-së						
Nën /Objektivi 1.1 Llogaritë Kombëtare						
1.1.1 Aplikimi i ndryshimeve nga ESA95 në ESA 2010	Njësia: LLK	Njësi tjetër në ASK, MF, BQK	Hulumtimi dhe Zhvillimi (R&D), Llogaritë Sektoriale, FISIM dhe të tjera	Në fazën fillestare planifikuese	2018-2022	Buxheti i Kosovës
	Njësia: LLK				2018-2022	

1.1.2 Përpilimi i tabelave ofruese-përdoruese (SUT) dhe Tabelat Input dhe Output (IOT),		Njësi tjetër në ASK, MF, BQK	Përgatitja e tabelave për vitet 2015-2018 (Produkt i ri)	Në fazën fillestare eksperimentale 2013 dhe 2014		Buxheti i Kosovës
1.1.3 Ngritja e efikasitetit me shkurtimin e kohës së publikimit të BPV vjetore dhe tremujore	Njësia: LLK	Njësi tjetër në ASK, MF, BQK	Reduktimi i kohës prodhuese për 21% për vjetore dhe 16% tremujore	BPV Vjetorje T+10 muaj, BPV Tremujore t+90 ditë	2018-2022	Buxheti i Kosovës
1.1.4 Matja e Ekonomisë joformale	Njësia: LLK	Njësi tjetër të ASK, MF (ATK dhe Dogana), MPB, dhe agjencitë publike	Shkalla e pjesëmarrjes së ekonomisë joformale në BPV (Produkt i ri)	Në fazën fillestare planifikuese	2018-2022	Buxheti i Kosovës dhe Banka Botërore

Nën /Objektivi: 1.2 Çmimet

1.2.1 Përmirësimi i cilësisë përmes monitorimit më të mirë të grumbullimit të të dhënave nga terreni	Njësia: Çmimet	Departamenti për Regjistrime dhe Anketime	Planifikohet të rritet numri i vendburimeve dhe numri i artikujve dhe shërbimeve, sipas E-COICOP-it. Për IHÇK. Rritja e mostrës të: Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP) Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) dhe Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN)	IHÇK (6000 çmime/ 1016 vendburime), IÇIMP (570çmime/132 vendburime), IÇP 600 çmime/180 vendburime) dhe IKN (341 çmime/68 vendburime)	2018-2022	Buxheti i Kosovës
1.2.2 Rritja e efikasitetit më futjen e aplikacionit të ri të TI-së dhe me përmirësimin e mbledhjes së të dhënave	Njësia: Çmimet	Departamenti për Regjistrime dhe Anketime, si dhe Njësia e TI	Reduktimi i kohës prodhuese për 13% (përfshirë IHÇK 3%)	IHÇK vjetore (t+157ditë) IHÇK mujore (t+12 ditë) IÇIMP (t+68 ditë), IÇP (t+70 ditë) IKN (t+73 ditë)	2018 - 2022	Buxheti i Kosovës

Nën /Objektivi: 1.3. Statistikat e Bizneseve

1.3.1 Përmirësimi i cilësisë me rritjen e monitorimit të grumbullimit të të dhënave nga terreni për të gjitha anketat e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN), PRODCOM, Statistikat Afatshkurtra (STASH) të hotelierisë, tregtisë me pakicë, industrisë, energjisë, transportit, ndërtimit etj.	Njësia: Statistikat e Biznesit	Departamenti për Regjistrime dhe Anketime, MPB, MZHE	Rritja e numrit të tabelave dhe dërgimi i tyre në Eurostat, Publikimi i Indeksit të prodhimit industrial etj.	Sipas Pocket book	2018 - 2022	
---	--------------------------------	--	---	-------------------	-------------	--

1.3.2 Rritja e efikasitetit me futjen e aplikacionit të ri të TI-së dhe me përmirësimin e mbledhjes së të dhënave	Njësia: Statistikat e Biznesit	Departamenti për Regjistrime dhe Anketime dhe Njësia e TI	Reduktimi i kohës prodhuese prej 10 deri 13% (përfshirë të Repertorit, statistikave të transportit dhe ASN me nga 3%)	ASN (t+339 ditë), Industrisë (t+81 ditë) Tregtisë me pakicë (t+82 ditë), Repertori (t+31 ditë), Transportit (t+30 ditë), Hotelierisë (t+68 ditë), Bilancit të Energjisë tremujore (t+48 ditë), Bilancit të Energjisë vjetore (t+186 ditë) dhe PRODCOM (t+347 ditë)	2018 -2022	
1.3.3 Organizimi i anketës së re për investime	Njësia: Statistikat e Biznesit	Grumbulluesi i të dhënave, Departamenti për Regjistrime dhe Anketime	Përgatitja e pyetësorit, mostrës. Mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe publikimi i të dhënave	Në fazën fillestare planifikuese	2018 -2022	
1.3.4. Organizimi i anketës së re për përdorimin e teknologjisë informative dhe komunikimit në biznese (ICT)	Njësia e statistikave të Biznesit	Grumbulluesi i të dhënave, Departamenti për Regjistrime dhe Anketime	Përgatitja e pyetësorit, mostrës. Mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe publikimi i të dhënave	Në fazën fillestare planifikuese	2018 -2022	
Nën /Objektivi: 1.4. Regjistri i bizneseve						
1.4.1 Azhurnimi i Regjistrimit Statistikor të Bizneseve sipas përparësisë të problemeve cilësore	Njësia: Regjistri Statistikor i Bizneseve	ARBK, ATK dhe Njësitë e tjera në ASK	Përgatitja në kohë dhe me cilësi e: mostrave për anketat e ndërmarrjeve, të dhënave për llogaritë kombëtare, plotësimi i raportit (sipas SMIS).	E vazhdueshme (e përhershme)	2018 -2022	
Nën /Objektivi: 1.5. Tregtia e Jashtme						
1.5.1 Rritja e efikasitetit me aplikimin e pajisjes së re të TI-së (Sistemi i Integruar i Shpërndarjes) për shpërndarjen e të dhënave.	Njësia: Tregtia e Jashtme	Dogana, BQK, MF	Reduktimi i kohës së prodhimit për 3%	T+25 ditë	2018 -2022	

Statistikat Sociale

Veprimi	Institucioni përgjegjës	Institucioni Partner	Treguesit vlerësues	Statusi i gjendjes bazë	Periodha kohore	Fondet
Objektivi i fushës së Statistikave Sociale: përmirësimi i cilësisë së të dhënave në harmoni me metodologjitë e Eurostatit, shkurtimi i afateve kohore të publikimeve, rritja e variablave të publikuara, zbatimi i Klasifikimeve Standarde Ndërkombëtare, zhvillimi i ad hoc moduleve dhe anketave të reja, transmetimi i më shumë të dhënave në Eurostat etj.						
Nën/Objektivi 1.1. Statistikat e Tregut të Punës						

1.1.1 Rritja e numrit të treguesve të rinj në AFP (zhvillimi i ad hoc moduleve)	Njësia: Tregu i Punës	ASK dhe Zyrat Rajonale	Zhvillimi i ad hoc moduleve të AFP-së dhe reduktimi i kohës së prodhimit (kalimi nga publikimet tremujore në mujore)	Ende nuk është zhvilluar ndonjë ad-hoc modul i AFP-së. Nga viti 2018, AFP-së do t'i shtohet çdo vit nga një ad-hoc modul	2021	BKK
1.1.2 Publikimi i të dhënave për nivelin e pagave në Kosovë në sektorin publik dhe privat, shtimi i treguesve të rinj	Njësia: Tregu i Punës	ASK, ATK, MAP	Shkurtimi i afatit të publikimit nga vjetore në tremujore	Për herë të parë janë publikuar të dhënat për vitet 2012-2016	2019	
Nën/Objektivi: 1.2 Statistikat e Standardit Jetësor						
1.2.1 Zhvillimi i Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushitet e Jetesës (anketë e rregullt vjetore)	Njësia: Standardi Jetësor	ASK, MPMS	Produkt i ri	Janë zhvilluar këto aktivitete: përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit, planifikimi i aktiviteteve në vitet 2017 dhe 2018 rreth zbatimit të anketës etj.	2019	Fondet e siguruar nga BB për vitin 2018 100,000\$
1.2.2 Zhvillimi i Anketës mbi Përdorimin e Teknologjisë Informative (TIK) përmes metodës CAPI	Njësia: Standardi Jetësor	ASK dhe Zyrat Rajonale	Zhvillimi i anketës përmes metodës CAPI	Për herë të parë Anketa TIK është zhvilluar në vitin 2017 dhe tutje do të vazhdojë si anketë e rregullt	2019	
1.2.3 Zhvillimi i Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare çdo 4 vjet (ABEF)	Njësia: Standardi Jetësor	ASK dhe Zyrat Rajonale	Zhvillimi i ABEF çdo 4 vjet	Zhvillimi i ABEF 2017 në terren përfundon më 31 dhjetor 2017, ndërsa tutje do të zhvillohet çdo 4 vjet	2021	
Nën/Objektivi: 1.3 Statistikat e tjera sociale						
1.3.1 Krijimi i qasjes së ASK-së në sistemin SMIA dhe SMIAL	Njësia: Statistikave e tjera sociale	MASHT	Reduktimi i kohës së prodhimit	Të dhënat e arsimit publikohen në bashkëpunim me MASHT, mirëpo ende nuk kemi qasje në sistemin SMIA	2019	
1.3.2 Implementimi i ISCED 2011	Njësia: Statistikave e tjera sociale	MASHT, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Agjencia Kosovare e Akreditimit	Kalimi nga ISCED97 në ISCED 2011	Është përgatitur draft harta për kalimin nga ISCED97 në ISCED 2011	2019	
1.3.4 Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të mirëqenies sociale	Njësia: Statistikave e tjera sociale	MPMS	Harmonizimi i metodologjisë me Eurostat	Është duke u bërë identifikimi i skemave të	2022	

dhe shkurtime i kohës së publikimit				reja të mirëqenies sociale		
1.3.6 Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të kulturës, si dhe publikimi i të dhënave të sportit	Njësia: Statistikave e tjera sociale	MKRS dhe Drejtoritë Komunale të Kulturës dhe Sportit	Publikimi i të dhënave të sportit pas shkëputjes 3 vjeçare	Janë zhvilluar takime me MKRS-n, por nuk ka pasur progres deri më tani	2020	
Nën/Objektivi: 1.4 Statistikat e Jurisprudencës						
1.4.1 Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të jurisprudencës për personat e mitur dhe madhorë	Njësia: Statistikat e Jurisprudencës	Gjykatat Themelore, MD, KGJ	Reduktimi i kohës së prodhimit	Është bërë identifikimi i mangësive kryesore të të dhënave statistikore për krimin dhe drejtësinë penale, që kërkohen nga Eurostat dhe UNDOC-ja	2019	
1.4.2 Zbatimi i Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Krimeve (KSNK)	Njësia: Statistikat e Jurisprudencës	Gjykatat Themelore, MD, KGJ	Raportimi i të dhënave në Eurostat sipas KSNK	Është duke u përkthyer në gjuhën shqipe Klasifikimi Ndërkombëtar i Krimeve	2019	
Nën/Objektivi: 1.5 Statistikat e Popullsisë						
1.5.1 Regjistrimi i Popullsisë, Eknomive Familjare dhe Banesave 2021	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, organizatat ndërkombëtare	Regjistrim sipas standardit botëror në çdo 10 vite	Regjistrimi i popullsisë 2011 dhe freskimi i Regjistrimit nga ky Regjistrim	2020-2022	
1.5.1 Digjitalizimi i Statistikave të Lindjeve	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Agjencia e Regjistrimit Civil	Reduktimi i kohës së prodhimit dhe ngritja e cilësisë	Janë zhvilluar takime, por pa progres	2022	
1.5.2 Digjitalizimi i Statistikave të Vdekjeve	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Agjencia e Regjistrimit Civil	Reduktimi i kohës së prodhimit dhe ngritja e cilësisë	Janë zhvilluar takime, por pa progres	2022	
1.5.3 Digjitalizimi i Statistikave të Kurorëzimeve	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Agjencia e Regjistrimit Civil	Reduktimi i kohës së prodhimit dhe ngritja e cilësisë	Janë zhvilluar takime, por pa progres	2022	
1.5.4 Përmirësimi plotësimi me të dhëna statistikore, bazuar në pyetjet e pyetësorëve statistikore të shkurorëzimeve nga njësitet raportuese (Gjykatat)	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Gjykatat Themelore	Ngritja e cilësisë së të dhënave	Janë zhvilluar takime, por pa progres	2022	
1.5.5 Kodifikimi i diagnozave që kanë shkaktuar vdekjet nga ana e personelit mjeksor	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik të Kosovës	Vazhdimi i përpunimit të statistikave të vdekjeve, sipas shkaqeve të vdekjeve në	IKSHPK nuk ka proceduar me kodifikimin	2018	

			Kosovë dhe publikimi i tyre			
1.5.6 Rritja e treguesve socio-ekonomikë për analizimin e situatës gjinore në Kosovë	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Institucionet qeveritare dhe joqeveritare	Ngritja e cilësisë së të dhënave, raportimi në Eurostat dhe Institutin Europian për Barazi Gjinore	Në proces	2018	
1.5.7 Rritja e treguesve kryesorë siç janë gjinia dhe mosha të vlerësi i numrit të banorëve në Kosovë	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Institucionet lokale dhe qendrore (raportimet e lëvizjeve të popullsisë)	Ngritja e cilësisë së të dhënave, raportimi në Eurostat	Është arritur progres dhe raporti do të jetë i gatshëm në vitin 2018	2018	
Nën/Objektivat e tjera nëse do të sigurohet buxhet nga BK ose donatorët						
Veprimi	Institucioni përgjegjës	Institucioni Partner	Treguesit vlerësues	Statusi i gjendjes bazë	Periudha kohore	Fondet
1.6.1 Zhvillimi i Anketës mbi Koston e Punës	Njësia: Tregu i Punës	ASK me Zyrat Rajonale, MPMS, Bizneset/Ndërmarrjet, Oda Ekonomike, Aleanca Kosovare e Bizneseve	Produkt i ri	Ende nuk ka filluar ndonjë aktivitet	2020	Projekti i BE-së
1.6.2 Zhvillimi i Anketës së Shëndetësisë	Njësia: Statistikat e tjera sociale	MSH, IKSHP	Produkt i ri	Ende nuk ka filluar ndonjë aktivitet	2019	?
1.6.3 Zhvillimi i Anketës mbi Arsimitin e të Rriturve	Njësia: Statistikat e tjera sociale	MASHT	Produkt i ri	Ende nuk ka filluar ndonjë aktivitet	2021	?
1.6.4 Zhvillimi i Anketës së Grupimeve të Treguesve të shumëfishtë (MICS)	Njësia: Statistikat e Popullsisë	MSH, IKSHP, MPMS, MASHT etj.	Kjo anketë për herë të parë është zhvilluar në vitin 2013	Në diskutim për fonde nga UNICEF dhe donatorët e tjerë	2018	?

Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Veprimi	Institucioni përgjegjës	Institucioni Partner	Treguesit vlerësues	Statusi i gjendjes bazë 2017	Periudha kohore	Fondet
Objektivi i Fushës së Statistikave të Bujqësisë: është të sigurojë informacion për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, që ka për qëllim ta ndihmojë Qeverinë e Kosovës në planifikimin e mirëfilltë të politikave bujqësore. Kjo fushë, po ashtu synon ta informojë publikun për gjendjen e ekonomive bujqësore në Kosovë, duke i krahasuar të dhënat me treguesit e BE-së						
Nën /Objektivi 1.1. Anketa e Ekonomive Bujqësore						
1.1.1 Organizimi dhe realizimi i Anketës së Ekonomive Bujqësore	Njësia e bujqësisë	MBPZHR	Anketa e përfunduar, Udhëzuesit e azhurnuar	Kryhet çdo vit në nëntor të çdo viti	2018 - 2022	Buxheti i ASK-së
1.1.2 Shkurtimi i kohës së prodhimit të rezultateve të AEB	Njësia e bujqësisë	TI	Reduktimi i kohës së prodhimit për 37 %	shkurtimi i kohës është bërë në vitin 2017, për 20 ditë	2018 - 2022	Buxheti i ASK-së
Nën /Objektivi: 1.2 Zhvillimi i prodhimeve të reja: Kryerja e Regjistrimit të Bujqësisë ose i Anketës Strukturore të Fermave, Anketës mbi Therjet e Kafshëve në Thertore (ATHKTH) dhe Anketa mbi Prodhimin e Qumështit (APQ)						
1.2.1 Përafrimi me kërkesat e BE-së, duke e kryer	Njësia e bujqësisë	MBPZHR	Pyetësore dhe udhëzuesit e përgatitur, testuar, Regjistrimi i kryer	Regjistrimi i fundit është kryer më 2014. Çdo 10 vjet duhet të	2022	Buxheti i Kosovës

Regjistrimin e Bujqësisë ose Anketën e Strukturës së Fermave (FSS)				kryhet. FSS duhet të kryhet çdo 3 vjet		dhe i Donatorëve
1.2.2. Anketa mbi Therjet e Kafshëve në Thertore (ATHKTH)	Njësia e bujqësisë	MBPZHR	Pyetësorët dhe udhëzuesit e përgatitur, Anketa e përfunduar, Rezultatet e prodhuara	Është testuar në vitin 2016 dhe 2017	2018 2022	Buxheti i ASK-së
1.2.3. Anketa mbi Prodhimin e Qumështit (APQ)	Njësia e bujqësisë	MBPZHR	Pyetësorët dhe udhëzuesit e përgatitur, Anketa e përfunduar, Rezultatet e prodhuara	Është testuar në vitin 2016 dhe 2017	2018 - 2022	Buxheti i ASK-së
Nën /Objektivi: 1.3 Standardizimi, përmirësimi i cilësisë dhe shkurtimi i kohës së prodhimit të rezultateve të Llogarive Ekonomike Bujqësore						
1.3.1. Standardizimi- Ndërrimi i vitit bazë për Indeks in e Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi	Njësia e statistikave agromonetare	Njësia e Çmimeve	Ndërrimi i vitit bazë për Indeks in e Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi nga 2015 = 100 në 2020 = 100	Viti bazë i indeksit nga 2010 = 100 në vitin 2015 = 100 është ndërruar gjatë vitit 2017	2022	Buxheti i ASK-së
1.3.2 Shkurtimi i kohës së prodhimit të Llogaritjeve Ekonomike në Bujqësi	Njësia e statistikave agromonetare	Njësia e Llogaritjeve Ekonomike në Bujqësi, MBPZHR	Reduktimi i kohës së prodhimit për 27%	Koha prodhuese gjatë vitit 2017 është shkurtuar për 20 ditë	2018 2022	Buxheti i ASK-së
Objektivi i Statistikave të Mjedisit: rritja e cilësisë së të dhënave, për të arritur një planifikim më të mirë mjedisor, në përdorimin e tokës, për menaxhimin e mbeturinave, monitorimin e cilësisë së ajrit dhe ujit në Kosovë, duke e aplikuar modelin DPSIR, si dhe standardet e tjera ndërkombëtare dhe prodhimin e treguesve të rinj dhe zhvillimi i prodhimeve të reja						
1.1.1 Përmirësimi i cilësisë së statistikave të mbeturinave komunale dhe shkurtimi i kohës së prodhimit	Njësia e statistikave të mjedisit	Njësia e Regjistrimit të Bizneseve, kompanitë publike, që merren me menaxhimin e mbeturinave	Shkurtimi i kohës së prodhimit për 37 %	Anketë e rregullt vjetore, shkurtimi i kohës prodhuese fillon në vitin 2018	2018 2022	Buxheti i ASK-së
1.1.2 Përmirësimi i cilësisë së statistikave të mbeturinave industriale dhe shkurtimi i kohës së prodhimit	Njësia e statistikave të mjedisit	Njësia e Regjistrimit të Bizneseve, Njësia e Metodologjisë së anketave	Zgjerimi i aktiviteteve ekonomike, të përfshira në anketë, të cilat ndikojnë në mjedis, Shkurtimi i kohës së prodhimit për 18 %	Anketë vjetore deri në vitin 2017. Nga viti 2018 do të kryhet çdo 2 vjet	2018 2022	Buxheti i ASK-së
1.1.3 Shkurtimi i kohës së prodhimit për Anketën e Mbeturinave të Trajtuar (AMT)	Njësia e statistikave të mjedisit	Njësia e Regjistrimit të Bizneseve	Shkurtimi i kohës së prodhimit për 17 %	Anketë e rregullt vjetore. Shkurtimi i kohës prodhuese fillon në vitin 2018	2018	Buxheti i ASK-së
1.1.4 Statistikat e ajrit-zhvillimi i statistikave të emitimit të gazrave serrë (GHGE)	Njësia e statistikave të mjedisit	MMPH	Llogaritja e emitimit të gazrave serrë, duke përfshirë më shumë sektorë dhe shkurtimi i kohës së publikimit për 1.5 %	Llogaritja e emitimit të gazrave serrë është bërë për sektorët: energji, bujqësi dhe mbeturina	2018 - 2022	Buxheti i ASK-së
1.1.5 Statistikat e ujërave. Zhvillimi i këtyre statistikave	Njësia e statistikave të mjedisit	MMPH	Pyetësorët dhe udhëzuesit e përgatitur. Të dhënat e grumbulluara. Statistikat e prodhuara	Publikohet çdo dy vjet. I fundit është i vitit 2016. I radhës është i vitit 2018	2018 - 2022	Buxheti i ASK-së
1.1.5 Zhvillimi i statistikave të tjera të mjedisit (Fakte mbi Mjedisin)	Njësia e statistikave të mjedisit	MMPH	Të dhënat e grumbulluara nga të gjitha burimet e mundshme. Statistikat e prodhuara	Publikohet çdo dy vjet. I fundit është i vitit 2017. I radhës është i vitit 2019	2019 - 2022	Buxheti i ASK-së

Shërbimet mbështetëse

Veprimi	Institucioni përgjegjës	Institucioni partner	Indikatorët vlerësues	Statusi i gjendjes bazë	Periudha kohore	Fondet
---------	-------------------------	----------------------	-----------------------	-------------------------	-----------------	--------

Objekti i Shërbimeve Mbështetëse Statistikore është për ta ndihmuar punën e njësive prodhuese në përmbushjen e detyrave të tyre

Fusha Mbështetëse/TI: Misioni i kësaj njësie mbështetëse është ta ndihmojë punën e departamenteve të fushave përkatëse në kryerjen e aktiviteteve statistikore, në mënyrë të lehtë dhe të thjeshtë, si dhe duke krijuar kapacitete për ruajtjen e të dhënave dhe mjete ose pajisje për shpërndarje

1.1.1 Përdorimi i sistemeve të avancuara për mbledhjen e të dhënave përmes metodës CAPI, CAËI dhe krijimi i sistemeve të mëtejme për mbledhjen e të dhënave	Njësia: TI dhe metodologji	Njësia: TI dhe metodologji, dhe departamentet prodhuese	Shkurtimi në kohë i mbledhjes së të dhënave, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve, rritja e kualitetit.	Përgatitja e dokumentimit, ToRs specifikacionet teknike për blerjen e pajisjeve të TI-së	2018-2022	Banka Botërore
1.1.2 Zhvillimi i një sistemi qendror të harmonizuar metadatash	Njësia: TI dhe metodologji	Të gjitha njësitë në ASK dhe autoritetet e tjera qeveritare përgjegjëse për statistikën zyrtare	Strategjia e vendosur	Është krijuar struktura për deponim dhe shpërndarje në formatin ESMS	2016-2020	Për vitin 2018 IPA2015, vitet e tjera ASK-ja
1.1.3 ASKData të fuqizohet si mjeti kryesor i shpërndarjes së të dhënave statistikore	Njësia: TI	Të gjitha njësitë në ASK dhe autoritetet e tjera	Qasje moderne në të dhëna statistikore	Sistemi në vend dhe i qasshëm nga përdoruesit	2016-2019	ASK
1.1.4 Dizajnimi i sistemeve të TI-së, që mbështetet në GSBPM	Njësia: TI dhe metodologji	Të gjitha njësitë në ASK	Rekomandimet nga "Peer Review"	I zbatuar pjesërisht në sistemin e SIPK-ut	2019-2022	ASK, IPA
1.1.5 Zhvillimi dhe krijimi i ueb GIS-it për shpërndarjen e të dhënave gjeo-hapësinore	Njësia: TI	Njësia: TI	Ueb Aplikacioni i gatshëm në janar 2019	Nuk është në dispozicion	2018-2019	Donator
1.1.6 Zhvillimi i veglave për vizualizim dhe krijimin e infografeve	Njësia: TI	Njësia: TI	Informacion i bazuar në koncept vizuel	Në dispozicion vetëm veglat për vizualizim StatPlanet	2019-2021	ASK
1.1.7 Përafrimi i kuadrit ligjor për përcaktimin e kufijve për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale sipas standardeve të kërkuara evropiane	Njësia: TI dhe metodologji	Njësia: TI dhe metodologji, si dhe departamentet e tjera	Përmirësimi i proceseve të sigurimit të konfidencialitetit statistikor	Statistikat Zyrtare dhe legjislacioni tjetër, lidhur me mbrojtjen e të dhënave në Kosovë	2019-2020	ASK
1.1.8 Zhvillimi i një infrastrukture të përshtatshme për qasje të sigurt nga ana e përdoruesve të jashtëm në të dhënat statistikore	Njësia: TI dhe metodologji	Njësia: TI dhe metodologji, si dhe departamentet e tjera, ASHI-MAP	Përmirësimi i proceseve të sigurimit të konfidencialitetit statistikor	Qasje vetëm përmes domainit të ASK-së	2020-2022	ASK, MAP

Fusha mbështetëse/Sistemi Informativ Gjeografik: Misioni i këtij shërbimi është ta mbështesë kryerjen e aktiviteteve statistikore të ASK, duke e ndihmuar mbulueshmërinë, gjetjen e subjekteve statistikore dhe shfrytëzimin e të dhënave territoriale

1.2.1 Korniza e mostrës të përditësohet në vazhdimësi	Njësia: GIS	Njësia: TI dhe metodologji	Azhurnimi i QR	Azhurnimi i fundit është bërë në vitin 2014	2018-2020	ASK, donator
1.2.2 Integrimi i sistemit të adresave në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), duke bashkëpunuar me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK)	Njësia: GIS	Njësia: TI dhe metodologji	Reduktimi i kohës së prodhimit për 25%	Është bërë integrimi i sistemit të adresave në 15 komuna	2018	ASK, AKK
1.2.3 Krijimi i Atlasit Statistikor me të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2021	Njësia: GIS	Njësia: Regjistrimi i Popullsisë		Atlasi Statistikor me të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2011	2022	ASK
Fusha mbështetëse/Shpërndarja (Diseminimi): Misioni i këtij shërbimi është t'i monitorojë nevojat e shfrytëzuesve dhe t'i sigurojë ata me informacion sipas kërkesës së tyre						
1.3.1 Të ndërtohet një dialog i rregullt me përdoruesit	Njësia: Diseminimi	Të gjithë përdoruesit	Dokumentimi periodik i kërkesave	Ka një dialog me përdoruesit, që duhet të fuqizohet	2017-2022	ASK
1.3.2 Prodhimi i vjetarëve statistikorë të Kosovës	Njësia: Diseminimi	Të gjitha njësitë e ASK- së	Vjetari Statistikor i gatshëm në 2016	Vjetari i fundit i publikuar në 2017	2017-2020	ASK

Statistikat financiare dhe të jashtme (BQK)

Veprimi	Institucioni përgjegjës	Institucioni Partner	Indikatorët vlerësues	Statusi i gjendjes në vitin 2017	Periodha Kohore	Fondet
<p>Qëllimi kryesor i BQK-së në lidhje me prodhimin e statistikave zyrtare është të zhvillojë më tej sistemin e saj statistikor në mënyrë që të përmbushë në mënyrë efektive nevojat e vendit për informacione relevante, të besueshme dhe të arritshme. Për të kontribuar efektivisht në vizionin brenda Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare, dhe bazuar në gjendjen aktuale, BQK ka identifikuar këto prioritetet strategjike për të udhëhequr punën tonë gjatë pesë viteve të ardhshme. Prioritetet strategjike janë:</p> <p>Nën /Objekti: 1.6. Statistikat monetare dhe financiare</p>						
1.6.1 Hartimi dhe publikimi i Rezervave Ndërkombëtare dhe Statistikave të Likuiditetit në Monedhën e Huaj	BQK	FMN	Zbatimi i manualit dhe i Udhëzuesit	2018	2018	

1.6.2. Harmonizimi i metodologjive statistikore të Kosovës në lidhje me statistikat e MFS sipas kërkesat e Banken Qendrore Evropiane	BQK	BQE	Zbatimi i manualit dhe Udhëzuesit	2018		
1.6.3 Forcimi i bashkëpunimit me institucionet vendase dhe të huaja në fushën e statistikave	BQK	FMN	Zbatimi i ligjit dhe rregulloreve	2018		
1.6.4. Shkurtimi i kohës së publikimit për statistikat bankare nga t + 25 ditë në t + 23 ditë dhe statistikat jo bankare nga t + 30 ditë deri në t + 25 ditë	BQK	Departamenti i statistikës	Reduktimi i kohës së publikimeve në 5 ditë	2018		
1.6.5. Përmirësimi i procesit të hartimit dhe shpërndarjes së statistikave monetare dhe financiare të cilësisë së lartë, siç rekomandohet me Manualin e fundit të MFS dhe Udhëzuesin e Hartimit (draft i parë i botuar në 2016). Përditësimi i koncepteve, përkufizimeve dhe rekomandimeve të bazuara në Manualin e botuar në vitin 2000.	BQK	FMN	Zbatimi i manualit dhe i Udhëzuesit, publikim i vitit 2016		2019	
1.6.6. Rishikimi i Rregullores mbi Rregullimin e Statistikave Monetare-Financiare dhe Statistikat e Llogarive Financiare dhe nëse është e nevojshme edhe të bëhen ndryshime për të qenë në përputhje me kërkesat e Bashkimit Europian dhe BQE-së	BQK	BQE	Zbatimi i manualit dhe i Udhëzuesit të BQE		2020	
1.6.7. Zhvillimi i Regjistrit të bazës së të dhënave të Institucioneve dhe filialave (ang. RIAD) për të ndjekur standardet e BQE-së, duke përdorur informacionin në dispozicion të regjistrit të bilancit të pagesave	BQK	Njësia e Regjistrit të Bizneseve, ITRS, MTI	Zbatimi i manualit dhe i Udhëzuesit të BQE		2021	
1.6.8. Zhvillimi dhe zbatimi i AnaCredit	BQK	BQE	Zbatimi i manualit dhe i Udhëzuesit të BQE		2021	
Nën /Objekti: 1.7. Statistikat e sektorit me jashtë						

1.7.1. Prezantimi i platformës se re statistikore online për të mbledhur të dhëna nga reporterët për vlerësimin e statistikave të investimeve direkte	BQK	Departamenti i teknologjis informative	Zbatimi i udhëzuesit		2018	
1.7.2. Zgjerimi i mbulimit të të dhënave për ndërmarrjet duke përfshirë më shumë kompani raportuese për të mbuluar më mirë statistikat e investimeve direkte;	BQK	FMN	Zbatimi i Udhëzuesit		2018	
1.7.3. Përmirësimi i proceseve të validimit të të dhënave të SSJ dhe përpunimi i të dhënave për përgatitjen e Formularëve të Raportimit që duhet të dorëzohen në Eurostat;	BQK	Eurostat	Udhëzimet e eurostatit		2018	
1.7.4. Publikimi i versionit të ri të Udhëzimeve Raportuese të ITRS	BQK	Bankat komerciale	Zbatimi i metodologjis së re		2018	
1.7.5. Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të të dhënave për anketat e ndërmarrjeve	BQK	Kompanit me kapital të huaj dhe kompanit të tjera me interes për BQK-ës	-		2018-2019	
1.7.7. Fillimi i procesit për përpilimin e Statistikave të Filialeve të Jashtme të Jashtme (OFATS), nëse është relevante	BQK	Divizioni i jashtëm i IHD, Statistikat Bankare, Statistikat jo-bankare, përdorimi i tyre nga BP, ASK	Përdorimi i udhëzuesve të eurostat dhe FMN		2019	
1.7.8. Krijimi i një kuadri për hartimin e Statistikave të Llogarisë Financiare dhe fillimi i hartimit të FAS (subjekt i burimeve shtesë dhe përmirësimeve në bazën ligjore)	BQK	Departamenti i statistikës			2019	
1.7.9. Publikimi i pozicioneve mujore të investimeve ndërkombëtare	BQK	Kompanit me kapital të huaj dhe kompanit të tjera me interes për BQK-ës			2019	
1.7.10. Përmirësimi i metadatave për të mbështetur analizën e të dhënave për përdoruesit për MFS dhe ESS	BQK	Kompanit me kapital të huaj dhe kompanit të tjera me interes për BQK-ës	Përdorimi i manuleve dhe udhëzuesve tjerë		2019	
Nën /Objektivi: 1.8. Objektivat tjera						

1.8.1. Zhvillimi i politikave të rishikimit të statistikave	BQK	Departamenti i Juridik			2018	
1.8.2. Vlerësimi mundësisë për krijimin e një kornize për hartimin e Statistikave Financiare të Kosovës për Kosovën	BQK	BQK			2018	
1.8.3. Përmirësimi i menuesë Statistikave në faqen e internetit të BQK-së	BQK	Departamenti i teknologjis informative			2018	
1.8.4. Krijimi i një kuadri adekuat ligjor për grumbullimin dhe shpërndarjen e statistikave të llogarisë financiare (ky zë i nënshtrohet burimeve shtesë);	BQK	Departamenti i Juridik			2019	

4.3 Prioritetet strategjike

Sistemi Statistikor i Kosovës (SSK) është një sistem i ri, por tashmë i konsoliduar. Kishte vështirësi dhe sfida për të arritur në këtë gjendje. Progresi është vlerësuar edhe nga organizma profesional ndërkombëtarë. Ky progres është arritur në saje të angazhimit të institucioneve, që prodhojnë statistika zyrtare, të cilat me mbështetjen edhe nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare kanë realizuar projekte të konsiderueshme, që nga fillimi i SSK-së.

Ligji aktual i Statistikave Zyrtare dhe legjislacioni sekondar, në kuadrin e SSK-së është zbatuar. Këshilli Statistikor ka funksionuar duke dhënë edhe rekomandime të rëndësishme. Gjithashtu, nga bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare për statistika dhe me përdoruesit, është në proces të finalizimit plotësim-ndryshimi i Ligjit për Statistika Zyrtare, që plotëson disa mungesa nga dispozitat e ligjit ekzistues për statistika zyrtare. Disa rregullore dhe udhëzime administrative, që trajtojnë lëndën statistikore janë duke u zbatuar. Rregullorja e riorganizimit vazhdon të zbatohet sipas prioriteteve institucionale, rregullorja e klasifikimit të aktiviteteve ekonomike është duke u zbatuar. Tashmë është konsoliduar rrethi planifikues, si dhe është dokumentuar ky proces planifikues përmes Planeve Vjetore, Raporteve Vjetore, Programeve strategjike dhe dokumentacioneve të tjera, që kanë ngritur nivelin institucional dhe profesional për prodhimin e statistikave zyrtare.

Ka një progres në Statistikat ekonomike të cilat ende përbëjnë rreth gjysmës së statistikave të prodhuara. Përparime janë bërë në statistikën makroekonomike dhe të çmimeve (konsumatori, importi, eksporti, etj). Progres është bërë në statistikën e popullsisë pas Rregjistrimit të Popullsisë 2011, përmes vlerësimeve vjetore të popullsisë dhe projeksioneve të popullsisë për perudhen afatgjate deri në 50 vite. Në statistikën Sociale është bërë progres në Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare dhe konsolidimit të Anketës së Fuqisë

Punëtore. Në statistikat Bujqësisë është bërë progres i madh me rastin e realizimit të Regjistrimit të Bujqësisë 2014, realizimin e Anketes së Ekonomive Bujqësore dhe vrojtimin e mbeturinave industriale.

Megjithatë, ekziston pajtueshmëri e plotë që Sistemi Statistikor i Kosovës në përgjithësi dhe ASK në veqanti, duhet të zhvillohen edhe më shumë, për të përmbushur standardet moderne dhe nevojat statistikore kombëtare dhe ndërkombëtare. Pas konsolidimit të arritur, nevoja kryesore është qëndrueshmëria e statistikave ekzistuese, zhvillimi i statistikave të reja dhe rritja e cilësisë së statistikave zyrtare. Pra, prioritet kyç është rritja e treguesve statistikorë, me synim strategjik cilësinë e tyre, pasi që dukshëm do të përmirësonin shfrytëzimin e tyre. Një prioritet tejter kyç është forcimi i sistemit nga pikëpamja organizative dhe funksionale. Institucioni qëndror statistikor ASK, duhet të implementoj rolin koordinues siç thuhet në Ligjin për Statistikat Zyrtare. Kjo kërkon që përveç avancimit të të ariturve në aspektin menaxherial, organizativ, në planifikim dhe raportim, të rritet më shumë niveli i koordinimit dhe komunikimi brenda sistemit duke përfshi edhe përdoruesit e statistikave zyrtare

Objektivat e përgjithshme operacionale të ASK-së janë:

- Fuqizimi i Sistemit Statistikor dhe prodhimit statistikor
- Përmbushja standardeve evropiane dhe ndërkombëtare për prodhimin e statistikave zyrtare

Për të përmbushur objektivat e përgjithshme të më sipërme, pavarësisht që deri tash ka një progres, duhet që të rritet edhe më shumë efikasiteti organizativ dhe efikasiteti i prodhimit statistikor tek objektivi i parë, ndërsa cilësia dhe leverdia e prodhimit statistikor duhet rriten edhe më shumë tek objektivi i dytë.

Dy shtyllat zhvillimore janë të ndërlidhura dhe mbështesin njëra tjetren. Objektivin e parë të përgjithshëm e formonë një grup i gjerë i prioriteteve të cilat mundësojnë zhvillimin organizativ. ASK tashmë ka rolin qëndror si institucion kryesor statistikor, por që duhet ta fuqizoj atë akoma më shumë në disa aspekte. Të gjitha prioritetet e vendosura janë konsideruar si realiste dhe mund të realizohen brenda afatit të periudhës së kësaj strategjie.

ASK-ja, gjithashtu do ta avancoj edhe më shumë procesin e saj planifikues (planifikimin dhe ciklin raportues) dhe do ta avancoj më shumë edhe kornizën monitoruese tashmë të zbatuar, e cila vazhdimisht do t'i ofojë procesit organizativ dhe procesit prodhues statistikor informacione të performancës. Pas realizimit të fazës kryesore të riorganizimit të ASK-së, do të vazhdohet me krijimin e Departamentit të llogarive kombëtare dhe racionalizimit të vendeve ekzistuese të punës sipas prioriteteve dhe informacioneve të KVP-së për reduktimin e kohës në prodhim. Do të aplikohet revidimi tek disa të dhëna të rëndësishme statistikore, si tek llogaritë kombëtare, në të dhënat tjera që do të ndikohen nga të dhënat që dalin nga Regjistrimi i Popullsisë 2021, etj. Pas krijimit të një niveli deri diku të kënaqshëm të dialogut më përdoruesit, synohet që ky dialog të arrij në nivelin e një dialogu sistematik me përdoruesit. Prioritet për ASK-në do të jetë gjithashtu edhe avancimi dhe zbatimi i teknologjisë informative, si dhe forcimi i shërbimeve mbështetëse. Zhvillimi i mëtejshëm i diseminimit dhe komunikimit, si dhe dokumentimi i metodologjisë dhe proceseve të prodhimit statistikor do të jetë një prioritet tjetër në periudhën e këtij dokumenti strategjik.

Realizimi i të gjitha prioritete do të monitorohen përmes indikatorëve në KVP. Për shembull indikatorët kryesorë nga 4-6 të KVP-së, do të monitorojnë progresin në produktivitet dhe efikasitet të prodhimit. Pritja është për një rritje të përgjithshme 25% gjatë periudhës së strategjisë 2018-2022.

Më poshtë janë paraqitur të renditura disa prioritete të kombinuara për efikasitetin organizativ dhe prodhues, për periudhën e ardhshme pesë vjeçare sipas prioritetit dhe periudhës së realizimit të tij.

Prioritetet e kombinuara për efikasitetin organizativ dhe prodhues:

Brenda kornizës së burimeve ekzistuese	Objektivi dhe korniza kohore
1. Avancimi i KVP	zhvillimi i moduleve të reja dhe trajnimi për shfrytëzimin e tyre (2018-2022)
2. Rritja e rolit koordinues të ASK	Rritja e efikasitetit në kuadër të SSK 2018-2022.
3. Rritja e kapaciteteve organizative të ASK-së	Krijimi i departamentit të llogarive kombëtare dhe rritja e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në një njësi tjetër të ASK, 2018-2022
4. Forcimi i komunikimit me përdoruesit	Rritja e bashkëpunimit dhe forcimi i marrëdhënieve me përdoruesit, 2018-2022
4. Avancimi i shpërndarjes	Finalizimi i listës së variablave dhe harmonizimi i serive kohore 2019-2022
5. Përdorimi më i mirë i metodologjive statistikore	Dokumentimi i të gjitha metodologjive dhe vlerësimet e tyre, 2018-2022.

Grupi i dytë i prioriteteve konsideron cilësinë e produkteve dhe shtrirjen. Tabela e mëposhtme përmbledh prioritetet e zhvillimit statistikor për 2018-2022:

Statistikat e prioriteteve të kombinuara :

Brenda kornizës së burimeve ekzistuese	Objektivi dhe korniza kohore
1. BPV	1.1 Aplikimi i ndryshimeve nga ESA95 ne ESA 2010, (2018-2022) 1.2 Perpilimi i tabelave ofruese-përdoruese (SUT)- 2019 1.3 Zhvillimi i llogarive sektoriale (2019) 1.4 Publikimi I te dhenave per ekonominë e pa vrojtuar (2020)
2. Statistikat e biznesit	2.1 Shkurtimi i kohës se prodhimit te SASH (2018-2022) 2.2 Rritja e prokuteve 2.3 Permiresimi I cilësisë
3.Çmimet	3.1 Shkurtimi i kohës se prodhimit per të gjitha indekset e cmimeve (perpos IHÇK) 3.2 Permiresimi i cilesise
4. Regjistri Statistikor I Bizneseve	4.1 Azhurnimi i Regjistrit të Bizneseve sipas përparësisë të problemeve kualitative.
5. Tregëtia e jashtme	5.1. Shkurtimi i periudhës publikuese per 3%
6.Anketa e ekonomive Bujqësore	6.1.Shkurtimi i periudhës prodhuese me 3 muaj deri më 2022
7. Statistikat agromonetare	7.1 Shkurtimi i periudhës prodhuese për llogaritjet ekonomike në bujqësi me 2 muaj deri më 2022 7.2 Standardizimi – Ndërrimi i vitit bazik të indeksit të çmimeve 2020 = 100
8. Statistikat e mjedisit	8.1 Anketa e Mbeturinave Komunale (AMK)- shkurtimi i kohës së prodhimit për 4 muaj deri më 2022; 8.2 Anketa e Mbeturinave Industriale (AMI) – Shkurtimi i kohës së prodhimit për AMI për 2 muaj deri më 2022; 8.3 Anketa e Mbeturinave të Trajtuar (AMT)- Shkurtimi i kohës së prodhimit për AMT rreth 1.5 muaj deri më 2022
9. Statistika tjera familjare dhe individuale (PKSZ)	9.1 Përmirësimi i kornizës mostër për anketat ne ekonomite falijare, 2018-2022 9.2 Rritja e numrit të indikatorëve të publikuar duke filluar nga 2018 9.3 krijimi i modeleve te reja

10. Vlerësimi vjetor i popullsisë (PKSZ)	10.1. Shfrytëzimi të dhënave të regjistrimit 2011 dhe 2021 10.2 Përdorimi i informacioneve e studimeve tjera 10.3 Shfrytëzimi i GIS
11. Të dhënat administrative	11.1 Percaktimi i të gjitha burimeve të dhënave të disponueshme 11.2 Nënshkrimi i MtM te reja me ofruesit tjetër të të dhënave 11.3 Percaktimi i rregullave te shkembimit të të dhënave

Jashtë kornizës burimore ekzistuese	Objektivi dhe korniza kohore
1.Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe Banesave	1.1 Parapërgatitjet për realizimin e Regjistrimit te popullsisë 2019-2020 1.2 Realizimi i regjistrimit te popullsisë 2021 1.3 Publikimi i rezultateve 2021-2022
2.Regjistrimi i Bujqsisë ose Anketa Strukturore e Fermave	2.1 Parapërgatitjet për realizimin e Regjistrimit te bujqësisë ose te strukturese se fermave në vitin 2022 2.2 Prodhimi i statistikave mbi strukturen e fermave
3. Anketa e kulturave bujqësore bimore	3.1 Realizimi i kësaj ankete dy herë në vit nga viti 2019 3.2 Prodhimi i statistikave mbi kulturat bujqësore bimore në harmoni me metodologjinë e BE-së
4. Anketa e Blegtorisë	4.1 Realizimi i kësaj ankete dy herë në vit nga viti 2019 4.2 Prodhimi i statistikave të blegtorisë në harmoni me metodologjinë e BE-së
5. Anketa mbi Therjet e Kafshëve në Thertore (ATHKTH)	5.1 Standardizimi me metodologjinë e BE-së i prodhimit të këtyre statistikave 5.2 Prodhimi i statistikave mbi therjet e kafshëve në baza të rregullta – mujore dhe vjetore nga viti 2019
6. Anketa mbi Prodhimin e Qumështit (APQ)	6.1 Standardizimi me metodologjinë e BE-së i këtyre statistikave 6.2 Prodhimi i statistikave të qumështit në baza mujore dhe vjetore nga viti 2019
7. Anketa Testuese në Pemtari	7.1 Parapërgatitjet për realizimin e Anketës Testuese në Pemtari 7.2 Testimi dhe realizimi i anketës në pemtari 2018

8. Statistikat e Pylltarisë

8.1 Grumbullimi i të dhënave nga burimet
administrative dhe nga anketat

8.2 Prodhimi i statistikave të pylltarisë

9. Pilot-Anketa mbi Ndërtimet dhe Demolimet

9.1 Parapërgatitjet për testimin e Anketës mbi
Ndërtimet dhe Demolimet

9.2 Testimi i kësaj ankete në vitin 2019

Anekset 1

Pershkrimi i produktit dhe procesit Statistikor

Përshkrimi i produktit statistikor									
Burimi	Informata themelore								
APOS	Emri i produktit statistikor								
APOS	Id-numri								
APOS	Departamenti përgjegjës								
APOS	Personi Raportues								
	Legjislacioni / Standardet								
	Kombëtar, ligjor / Komiza rregullative			2013	2014	2015	2016	2017	
	Standardet ndërkombëtare								
	Përmbajtje								
	Objekti/ Popullsia								
	Variablat kryesore								
	Numri i treguesve të botuar								
	Nivelet disagregimit								
APOS	Frekuenca referencë kohe/periudha								
APOS	Koha e Publikimit								
	Mënyra e publikimit								
	Krahasueshmëria								
	Përdoruesit kryesore								
	Përdoruesit kombëtare								
	Përdoruesit ndërkombëtare								
	Prodhimi								
	Partnerët prodhimit								
	Mënyra e mbledhjes së të dhënave								
	Çështje të tjera metodologjike								
APOS	Koha e prodhimit								
	Transmetimi i të të dhënave tek marrësit								
	Burime								
APOS	Ditë-njerez ne inputeve								
APOS	Shërbimet mbështetëse kombetare								
APOS	Shërbimet te jashtme mbështetëse								
APOS	Buxheti brendshem								
APOS	Mbështetje financiare të jashtme								

Departmen/Procesi i punes/prodhimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gusht	Shta	Tet	Nen	Dhjet	Dite pune	Njesia/PRS	Buxheti
DEPT NN													975		
1 Percaktimi i nevojave		20	20			20							60		
2 Dizajnimi dhe plani							20	20	132	20			192		
3 Krijimi dhe testimi								5	5	22			32		
4 Grumbullimi											X		0		
5 Vendosja e shenimeve	163	90	90									163	506		
6 Perpunimi i te dhenave				110									110		
7 Publikimi dhe komunikimi					75								75		
	163	110	110	110	75	20	20	20	137	25	22	163			
<i>Rajonal</i>												154	154		
<i>Data entry</i>														(transport Data entry plan)	
<i>IT/Medologjia</i>	5						5			10	15	5	40	ransport IT/M plan)	
<i>Assistenca teknike</i>				18					5				23		

Aneksi 2

Pyetësi i përdoruesve

PYETËSORI I PËRDORUESIT				
Burimi	Informacioni Baze			Information i përdoruesit
APOS	Informata themelore			Emri dhe adresa e organizatës
APOS	Ndihmuar prej personit			Emri i personit të intervistuar
APOS	Id-numri			Numri i kontaktit
APOS	Departamenti përgjegjës			Data e intervistës
	Personi raportues			
Përgjigje nga përdoruesit				
Aspekte të cilësisë				
		Si	Kur	Pse
1	Dobia e statistikave (Relevance)			Per çfare
		Kënaqësia	Pakënaqësia	Problemi
2	Mbulimi i produktit	<input type="text"/>	<input type="text"/>	Zgjidhja
3	Saktësia	<input type="text"/>	<input type="text"/>	
4	Përpikmëria Përpikëria	<input type="text"/>	<input type="text"/>	
5	Krahasueshmëria (koha, gjeografia, theme)	<input type="text"/>	<input type="text"/>	
6	Arritshmëria/Qartësia	<input type="text"/>	<input type="text"/>	
Çështjet e koordinimit				
7	A keni një MM me prodhuesin?	Po <input type="text"/>	Jo <input type="text"/>	
8	Frekuenca e kontaktit me prodhuesin	Mujore <input type="text"/>	Tremujore <input type="text"/>	Vjetore <input type="text"/>
9	Aspekte të ndërveprimit: Nëse ju keni një memorandum, sa shpesh ju perditsoni ate? A keni propozuar ndryshime në pyetësor? Sa shpesh ju përmbushen kerkesat? A shkëmbeni ju informacion, shkruani e-mail, etj?	<input type="text"/>		
10	Çështje të tjera (perceptimi i produktit etj)	<input type="text"/>		
11	Sugjerime për permirsimin e prodhimit të statistikave në përgjithësi	<input type="text"/>		
TË PLOTËSOHET NGA PRODHUESIT				
12	Komentet dhe sugjerimet nga departamenti përgjegjës prodhimit	<input type="text"/>		

Aneksi 3

Buxheti ASK €	2017	2018
Paga dhe medetje		
Mallra dhe sherbime		
Shpenzime kapitale		
Komunali		
Totali		
Punonjes		

Buxheti BQK €	2017	2018
Paga dhe medetje		
Mallra dhe sherbime		
Shpenzime kapitale		
Komunali		
Totali		
Punonjes		

Buxheti DME €	2017	2018
Paga dhe medetje		
Mallra dhe sherbime		
Shpenzime kapitale		
Komunali		
Totali		
Punonjes		

Aneksi 4

Referenca:

1. Ligj No. 04/L-036 PER STATISTIKAT ZYRTARE NE REPUBLIKEN E KOSOVES – GAZETA ZYRTARE / No. 26 / 25 NENTOR 2011
2. Ligji i Buxhetit për vitin 2017, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës
3. Ligji për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave
4. Ligji për Regjistrimin e Bujqësisë
5. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
6. UDHEZIMI ADMINISTRATIV NO. 02/2012 MBI PROCEDURAT, KRITERET DHE METHODOLOGJINE E PREGATITJES DHE APROVIMIT TE DOKUMENTEVE TE STRATEGJIVE DHE PLANEVE PER ZBATIMIN E TYRE, Qeveria e Kosoves.
7. Udhëzimi Administrativ për kushtet dhe mënyrën e ofrimit të të dhënave statistikore të fituara me përpunime të veçanta të statistikave zyrtare Nr.08/2012
8. Udhëzimi Administrativ Nr.11/2012 për ruajtjen dhe shfrytëzimin e lëndës statistikore
9. Rregullorja për Riorganizimin e ASK-së
10. Rregullorja mbi funksionimin e Kwshillit Statistikor, 11 Maj 2012
11. Kodi i praktikës statistikore të Bashkimit Europian, miratuar nga Komiteti mbi Sistemin Europian të Statistikës, 28 Shtator 2011
12. Vlerësimi i përgjithshëm i miratuar i Sistemit të Statistikave në Kosovë, Eurostat, 20 Janar 2012
13. Plani vjetor i Statistikave zyrtare 2013, 31 Maj 2012, Prishtinë
14. Plani Strategjik për periudhën 2010-2015 – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë, Tetor 2009 – të shikohet
15. Korniza e shpenzimeve afatmesme 2018-2020, Prill 2017
16. Plani i Zhvillimit Strategjik 2012 – 2014, Ministria e Financës No. 23/53 21 Dhjetor 2012, Prishtinë – të konsultohet me MF
17. Studimi i fizibilitetit për Stabilizim Asociimit midis Bashkimit Evropian dhe Kosovës, Bruksel 10 Tetor 2012
18. Të shtohen planet vjetore dhe raportet vjetore
19. Raporti i Peer Review 2017
20. Rekomandimet e Kwshillit Statistikor
21. Raportet nga Sistemi SIPK
22. projekti i ardhshëm trevjeçar BE-ASK